Eftali Qirjaq
AUDITUES LIGJOR
Licence Nr. 13, Date [illegible], NIPT K46526078J, Lagje
"Qemal Stafa", Rr. "Studenti", Shkoder
Mobile +35569[illegible]
Email: [illegible]@yahoo.com

# RAPORTI I AUDITUESIT LIGJOR

**Eftali QIRJAQI**
NIPT: K46526078J
**Adresa:** Lagje "Qemal Stafa", Rruga "Studenti", Shkodër, Albania

## MBI PASQYRAT FINANCIARE

(Për periudhën 1 Janar 2018 - 31 Dhjetor 2018)

**PARTIA ALEANCA POPULLORE**

**Adresa:** Rruga Pjeter Bogdani, nr.13/1, Tiranë
**NIPT:** L31713451I

Shkodër, Qershor 2019

# RAPORT PER AUDITIMIN E RAPORTITIMIT VJETOR FNANCIAR TË PARTISË ALEANCA POPULLORE

(Hartuar sipas formatit të standartizuar nga KQZ-ja)

**Për Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve**
Rruga "Ibrahim Rrugova", Nr. 4, Tiranë, Shqipëri

## I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Ne jemi angazhuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve(KQZ) në misionin e auditimit ligjor të detyrueshëm, të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018 nga Partia Aleanca Popullore, të raportuara prej saj në raportin vjetor financiar (Pasqyrat financiare) , i cili është depozituar në KQZ-ë dhe është publikuar prej saj.
Me përfundimin e procesit te auditimit, po ju paraqisim raportin tonë të hartuar sipas formatit të standartizuar të miratuar nga KQZ-ja.

### A. INFORMACIONI LIGJOR

#### i. Kuadri ligjor

Ashtu siç referohet dhe në kontratën e shërbimit auditimi ligjor i raporteve vjetore financiare të partive politike kërkohet dhe realizohet në zbatim të kerkesave të:

- Ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar
- Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar,
- Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" indryshuar,
- Legjislacionit në fushes fiskale,si dhe,
- Akteve nënligjore te KQZ-së te miratuara për këtë qëllim

Nga pikëpamja profesionale kryerja e auditimit ligjor bazohet ne Standardet Ndërkombëtare te Auditimit (SNA-të) të miratuara dhe të publikuara nga bordi i standardeve ndërkombëtare të auditimit dhe të dhenies së sigurisë të Federatës Nderkombëtare të Kontabilisteve (FNK), te detyrueshme për zbatim nga ligji për auditimin i sipërcituar.

#### ii. Standartet e kontabilitetit të zbatueshme

Ne përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 ,"Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar , partitë po tike kanë statusin e njësive jofitimprurëse dhe janë objekt i Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe specifikisht i Standardit Kombëtar te Kontabilitetit të Organizatave Jo Fitimprurëse (SKK për OJF-te).

Partia Aleanca Popullore , ka përgatit pasqyrat financire (raporte vjetore) sipas ketyre kërkesave.

## B. OBJEKTI I AUDITIMIT

### i. Kontrata e shërbimit

Për permbushjen e misionit të auditimit, me palën angazhuese KQZ-në, u lidh kontrata e sherbimit me numer 889/1 datë 18.05.2019,me objekt: "Kryerja e auditimit ligjor të detyrueshem të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik 2018, nga partite politike në përputhje me ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000 "Per partitë politike", i ndryshuar, aktet nënligjore të KQZ-së të miratuara për ketë qëllim, ligjin nr. 10091, date 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratur", i ndryshuar, dhe ligjin nr. nr. 9228, datë 29.04.2004 ,"Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", se dhe aktet nenligjore te nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre".

Me daten 04.06.2019 është lidhur kontrata me Partinë Aleanca Popullore, me qëllim që të dokumentojë dhe konfirmojë pranimin dhe kushtet te angazhimit, si palë përgjegjëse e raportimeve financiare që do te auditohen.

### ii. Vendimi i KQZ-së

Në perputhje me kuadrin rregullator të përzgjedhjes dhe emërimit të expertëve kontabël të licencuar për auditimin e partive politike, KQZ-ja me vendimin nr.112 datë 27.03.2019 ora 12.00 më ka emeruar si auditues të Partise Aleanca Popullore.

### iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

Përgjegjësitë e drejtimit te partisë

Auditimi yne do të kryhet bazuar në faktin që drejtimi i Partisë Aleanca Popullore ka përgjegjesi:

a) Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare(raportit vjetor) në pajtim me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo-Fitimprurese (SKK për OJF-të) dhe me kërkesat specifike të ligjit "Për Partitë Politike" i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qëndror të Zgjedhjeve (KQZ-së);

b) Per kontrollet e brendshme te atilla qe drejtimi partisë i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale nga mashtrimi apo gabimi;

c) T'i japin audituesit:

- Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi ka dijeni se jane të nevojshme për përgatitjen e pasqyrave financiare, siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera
- Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit
- Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat brenda partisë nga të cilet audituesi e gjykon të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit, ne kërkojmë nga drejtimi i partisë dhe, kur është e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me administrimin që të marrim prej tyre konfirmime me shkrim lidhur me deklarimet me gojë që do të na bëhen në lidhje me auditimin.

Pergjegjësitë e audituesit

Auditimi ni do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që ne te respektojmë kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi sipas SNA-ve, ne do të ushtrojmë gjykimin profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit.

Objektivat tona janë që të arrijmë nje siguri të arësyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare (raporti vjetor financiar) në tërësi nuk kane anomali materiale, për shkak mashtrimit apo gabimit, dhe të leshojmë një raport auditim. që përfshin opinionin tonë. Siguria e arësyeshme është nje siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci qe një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indivigualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyre te arësyeshme të influencojnë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Gjithashtu kemi dhe pergjegjësi të tjera raportuese që burojnë nga termat e kontratës, për të vlerësuar përputhshmërinë e veprimeve ekonomike dhe financiare qe lidhen me kërkesat specifike te ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe udhezimet e KQZ-se si burimet e financimit, procedurat e marrjes së donacioneve jopublike, dokumentimit dhe të regjistrimit të tyre, identifikimin e dhuruesve, publikimin e tyre, etj.

## C. INFORMACION MBI SUBJEKTIN POLITIK

### i. Prezantimi i subjektit politik

Partia Aleanca Popullore, është themeluar me 27 dhjetor 2001 dhe vepron ne perputhje me ligjin nr.8580 date 17.02.2000 "Për Partite Politike" i ndryshuar, statutin e saj dhe kuadrin ligjor shqiptar.

Ajo është një organizim politik i qytetarëve, të grupuar me vullnet të lirë mbi bazën e ideve, bindjeve dhe interesave politike. me struktura të organizuara mbi bazën e ndarjes territoriale, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesmarrjes në zgjedhje dhe perfaqësimit në organet e pushtetit.

Burimet financiare të Partisë përbëhen nga kontributet ne te ho'la që ligji për partitë politike i konsideron te drejta, si dhe nga çdo burim tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

Partia Aleanca Popullore si person juridik, është e regjistruar në sistemin tatimor me NIPT. L31713451I dhe ka bërë deklarimet e duhura sipas përgjegjesive tatimore dhe aktivitetit qe ajo ka kryer. Gjithashtu ajo ka plotësuar detyrimin ndaj KQZ-së për dorëzimin raportit vjetor financiar 2018 ne KQZ me numer prot 2102 date 01 prill 2019

ii. **Forma e organizimit dhe menaxhimit të partisë**

Sipas statutit struktura e organizimit dhe e drejtimit të Partisë Aleanca Popullore përbehet:

a. Seksionet
b. Deget
c. Nendege
d. Organet qendrore
e. Organet Konsultative

Organet qendrore perbehen nga:

f. Kuvendi kombetar
g. Keshilli kombetar
h. Kryesia e Partise
i. Kryetari i Partise

Selia qëndrore e saj ndodhet në Tiranë, në adresën, Rruga Pjeter Bogdani, nr. 13/1 Tirane, e cila eshtë marre në perdorim nga shpk I.C.E Tirane, dhënë partisë në përdorim pa vlera monetare siparfaqe minimaliste 5 m2

Nuk disponohte fature dhe nuk deklarohej shpenzim meqenese ishte pa vlere monetare.

Strukturat vendore janë te ngritura dhe funksionojnë ne qarqe, por nuk kanë zyra dhe ambjente fikse, në pronësi, përdorim apo me qera dhe nuk kanë funksione administrimi në burimet dhe përdorimet e fondeve të partisë.

Kryerja e funksioneve të drejtimit politik dhe funksioneve të tjera ndihmese bazohet kryesisht në punën vullnetare të antareve të saj. Por për ndjekjen e përhereshme të aktiviteteve kryesore në seline qendrore, për vitin 2018, ishte angazhuar me kontrata punësimi vetem nje person i cili kryente te gjitha funksionet dhe ishte i dypunesuar.

Veprimtaria ekonomike e partisë administrohet nga sekretari i Partisë (me prokure nga kryetari), i cili kontrollon burimet dhe përdorimin e fondeve financiare në funksion të aktiviteteve të dhe qëllimeve të partisë, si dhe shqyrton raportet financiare para dorëzimit te tyre ne organet kompetente shtetërore dhe të partise.

Sistemi i kontabilitetit i cili ishte minimalist është i organizuar në selinë qëndrore të partise dhe realizohet nga shërbime vullnetare. Deget në qarqe nuk kanë detyra administrimi.

## D. PREZANTIMI I RAPORTIT VJETOR DHE STRUKTURA E TIJ

### i. Struktura e raportit- kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet.

Stuktura e raportit vjetor financiar(Pasqyrat financiare) të Partisë Aleanca Popullore, të publikuara në KQZ-e, përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performanes (pasqyra e aktiviteteve) dhe pasqyra e flukseve të parasë, paraqitur me të dy metodat, si edhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare minimaliste vetem per shpjegimet e te ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. **Takimet dhe komunikimet midis audituesit dhe subjektit zgjedhor dhe çdo personi tjetër të tretë.**

Menjëherë pas firmosjen e kontratës me KQZ-në, në datën 18.05.2019 u vendosën kontaktet me personelin që merret me administrimin e partisë, dhe në këtë datë 04/06/2019 u nënshkrua kontrata me të perfaqësuarin me prokure të partisë, z.Klodian Shatraj, në të cilen u përcaktuan termat e angazhimit dhe pergjegjësitë reciproke të palëve. Ne vijim u bashkëpunua në vazhdimesi me personelin që merret me çështjet ekonomike dhe të shërbimit kontabel. z, Klodian Shatraj dhe Frinda Ndreko i kontraktuar për vitin 2019, prej të cilëve siguruam raportin vjetor financiar per vitin 2018 dhe 2017, dokumentacionin kontabel, rregjistrimet dhe informacione të tjera që lidhen me auditimin tonë.

iii. **Paraqitje e përgjithshme e raportit vjetor të partisë politike, përputhshmëria e tij me kërkesat e raportimit.**

Ne vlerësuam paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit vjetor ( pasqyrave financiare), përfshirë informacionet shpjeguese të dhena, të publikuar per vitin 2018 nga Partia Aleanca Popullore, nëse ato paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në menyren që të japin paraqitjen e drejt.

Raporti vjetor financiar, i paraqitur dhe publikuar në KQZ-e, është hartuar sipas SKK-ve, saktësisht sipas SKK-ve per OJF. Duke qene se aktiviteti eshte minimalist te ardhurat perbeheshin vetem nga kontribute vullnetare kryesisht per te mbulluar shpenzimet minimaliste.

## II. KËRKESAT FORMALE TE RAPORTIT VJETOR

### A. PËRMBLEDHJE

| | | | |
|---|---|---|---|
| **1. Data e dorëzimit të raportit vjetor** | | | |
| | Dorëzimi fizik | Po | Datë, 01.04.2019 |
| **2. Nënshkrimi** | | | |
| | Nenshkrimi | Po | Date, 29.03.2019 |
| | Identiteti i nënshkruesit | Po | Klodian Shatraj-Sekretar i Partisë , me prokur për veprime nr.4467 rep. 3180 prot. Leshuar nga Kryetari Artur Dojaka |

## B. INFORMACION MBI PARTIN,AUDITUESIN DHE LLOGARITE BANKARE

### 1. Informacioni për partinë politike

| | |
|---|---|
| Emri i partisë politike | Partia Aleanca Popullore |
| Adresa e selisë qendrore | Rruga "Pjeter Bogdani" nr.13/1, Tiranë. |
| Numri i telefonit të selisë qendrore | ska |
| Adresa e e-mailit të selisë qendrore të partisë (nëse ka) | infoaleancapopullore.al |

### 2. Informacion për audituesin ligjor

| | |
|---|---|
| Emri i audituesit ligjor të caktuar | Eftali Qirjaqi |
| Adresa e audituesit ligjor | Lagje "Qemal Stafa", Rr. "Studenti", Shkoder |
| Numri i telefonit të audituesit ligjor | +355 692069434 |
| Adresa e e-mailit te audituesit ligjor. | eliqirjaqi@yahoo.com |

### 3. Të dhënat e llogarisë bankare të partisë politike

| | |
|---|---|
| Emri i bankës ku mbahet llogaria | -Banka Kombëtare Tregtare sh.a(BKT) |
| Adresa e zyrës së bankës ku mbahet llogaria | -BKT,Rruga Ismail Qemali, ish blloku |
| Numri i telefonit të zyrës së bankës | - BKT, +355 42261651 |
| Adresa e e-mailit të zyrës së bankës apo zyrtarit përgjegjës të bankës. | -Mbudina@bkt.com.al |
| Numri i llogarisë bankare | -BKT-AL3920511021685035CLTCLALLOJ |
| Emrat dhe nënshkrimi i të gjithë personave të autorizuar për veprimet tek llogaria bankare | Artur Dojaka me nr ID H00606100P<br>Klodian Shatraj me nr Id I102262405 |

## C. AKTIVET DHE DETYRIMET

### 1.Kriteret e klasifikimit të aktiveve

Përshkrimi natyrës së secilit aktiv, pronë e partisë, në datën e vlerësimit

Sipas natyrës, aktivet në datën e mbylljes së pasqyrave financiarem, 31.12.2018 përbëhen:

- *Mjete monetare në arkë dhe në bankë*

**1.Kriteret e klasifikimit të aktiveve**

- *Aktive afatëgjata materiale te luajtëshme automjete, në përdorim nga Artur Dojaka*

Pershkrimi i vendndodhjen e aktivit

- *Vendndodhja e aktiveve eshte prane selisë qëndrore.*
- *Nuk ka aktive të administruara nga degët e partisë ne qarqe dhe bashki, pasi ne to nuk ka zyra dhe detyra administrimi.*

Vlerat e tregut të aktivit, në datën e vlerësimit nëse është bërë vlerësim, ose vleren kontabel të mbetur

- ***Mjete monetare në arkë dhe ë bankë 31.12.2018.***
  *Llogaria bankare pranë bankes Kombetare Tregetare* ........................................ 700 leke
  *Mjete monetare ne arkë* ........................................ 80 lekë
  *Shuma mjete monetare* 780 lekë
- **Aktive afatëgjata materiale**
  *Aktive afatëgjata materiale,me koston e blerjes dhe të krijimit* ............ 2.500.000 lekë
  Amortizimi i akumuluar ........................................ (1.284.000) leke
  Aktive afatëgjata materiale neto ........................................ 1.216.000 lekë

**2.Kriteret e klasifikimit të detyrimeve**

Përshkrimi i llojit të secilit detyrim të partisë, në datën e vlerësimit

Sipas llojit, detyrimet në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, 31.12.2018 përbëhen.

- *Detyrime ndaj furnitorëve per mallra e sherbime*
- *Detyrime per sigurime shoqërore dhe,*
- *Të tjera të pagueshme paga.*

Shkruani emrin e kreditorit për detyrimet

- Furnitore per mallra e sherbime
  I.C.E shpk (detyrim blerje makine) ........................................ 2.500.000 lekë
  Sigurime shoqerore dhe shendetesore ........................................ 6.696 lekë
  Vodafon ........................................ 13.774 lekë
  Paga punonjesish ........................................ 1.985.272 lekë

Totali detyrime ........................................ 4.505.742 lekë

Vlera e detyrimit në datën e vleresimit dhe kushtet e shlyerjeve

- Detyrimet ndaj furnitore per mallra e sherbime jane detyrime te prapambetura nga viti 2015 te aktivitetit per furnizimin me nje makine nga firma I.C.E me fature tatimore te rregullt por pa kushte shlyerjes te furnizimit ose kushte renduese.Ky detyrim nuk eshte likuiduar edhe ne momentin e kryerjes se auditimit.

**1.Kriteret e klasifikimit të aktiveve**

- Detyrimi ndaj sigurimeve shoqërore eshte detyrimi i muajit dhjetor 2018 qe paguhet deri ne 20 janar 2019 .Nga verifikimi i ngjarjeve mbas bilancit ky detyrim eshte i likuiduar në vitin 2019.

- Detyrimi ndaj vodafonit eshte detyrimi i muajit dhjetor 2018 që paguhet ne janar 2019 .Nga verifikimi i ngjarjeve mbas bilancit ky detyrim është i likujduar në vitin 2019.

- Detyrimi për pagat nuk është likuiduar edhe mbas bilancit

## D. PËRMBLEDHJE FINANCIARE

**Përmbledhje Financiare**

| | |
|---|---|
| Periudha e raportimit (data e pare dhe e fundit e periudhës që mbulon raporti). | 01 Janar 2018-31 Dhjetor 2018 |
| Shuma e parave në arke ne fillim dhe në fund të periudhës së raportimit (data e pare dhe e fundit e periudhës që mbulon raporti). | *Gjendja e arkes 01.01.2018........808 leke*<br>*Gjendja e arkes 31.12.2018........80 leke* |
| Shuma e përgjithshme e te gjithë kontributeve të marra | *Te ardhura gjithsej..........326.700 lekë* |
| Shuma e përgjithshme e të gjitha shpenzimeve te bëra. | Shpenzime gjithsej............901.580 lekë |
| Bilanci ne fund të periudhës së raportimit (data e fundit që mbulon periudhën). | 31 Dhjetor 2018 |
| Shuma e përgjithshme e të gjithe aktiveve ne fund te periudhës së raportimit | Aktivi 31.12.2018...........1.216.780 lekë |
| Shuma e pergjithshme e te gjithe detyrimeve në fund të periudhës së raportimit | Detyrime 31.12.2018..........4.505.742 lekë |

Diferenca midis aktiveve dhe detyrimeve jane aktive neto negative.

**a.Vlerësimi i informacionit dokumentar mbi llogaritë bankare**

Nga evidenca dokumentare që morëm nga drejtimi i partisë rezulton se Partia Aleanca Popullore ka hapur një llogari bankare ne monedhen "Leke" në Banken Kombetare Tregetare sh.a. Ne kemi marre lëvizjet e llogarise bankare (bank statement) për të gjithe vitin financiar nga 1 janari 2018 deri ne 31 Dhjetor 2018.

Nga auditimi rezultoi se transaksionet jane regjistruar, klasifikuar dhe raportuar ne menyre te rregullt dhe nuk u kostatuan gabime apo mosperputhje me kerkesat rregullatore.

Për vitin 2018 janë evidentuar dhurime nga fonde jopublike por nga antaresia me vlera individuale me te vogla se 100 mije.

**b.Vleresimi i dokumentacionit mbështetës të pasqyrave financiare**

Ne kërkuam dhe siguruam nga partia dokumentat mbështetës mbi të cilat janë hartuar pasqyrat financiare sipas funksionimit dhe natyres si; mjetet monetare/financimet (statementet bankare dhe dokumentat arkës), blerjet/kreditorët (faturat e blerjes se mallrave dhe shërbimeve), aktivet afatgjata materiale(inventarin fizik dhe pasqyrat llogaritëse te amortizimit), pagat dhe sigurimet (listëpagesat, kontratat e punes), tatimet (deklaratat për tatimin në burim dhe TAP), si dhe dokumenta të tjera kontabël, bazë dhe permbledhes, lidhur me kontribute në natyrë, kontrata qiraje etj.

Ne i shqyrtuam pothuajse te gjithë dokumentat, pasi ato ishin relativisht të pakta në numër, nëse ishin të plota, pasqyronin transaksionet dhe ngjarjet e ndodhura gjatë periudhes dhe a perkisnin subjektit politik . Nga verifikimi, nuk u konstatua ndonje parregullsi nga shqyrtimi formal i tyre.

**c.Kontrolli i elementeve të aktiveve dhe detyrimeve në Pasqyrën e Pozicionit Financiar**

**Mjetet monetare**

Nga auditimi i mjeteve monetare në banke dhe arke, verifikimi i gjendjeve ne fillim te ushtrimit dhe levizjeve të ndodhura gjatë vitit, rezultoi se gjendjet e tyre ne fund të ushtrimit të paraqitura në aktivin e bilancit jane të rregullta. Ato konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarin fizik të arkës dhe proces verbal arke ne fund të ushtrimit dhe paraqiten si vijon:

Gjendja e mjeteve monetare në arkë dhe në bankë 31.12.2018 (Statementet bankare dhe inventari fizik i arkës):

Llogaria bankare pranë BKT........................................................................700 lekë

Mjete monetare ne arke...............................................................................80 lekë

Shuma e mjeteve monetare 760 lekë

**Aktivet afatgjata materiale**

Po ashtu u verifikuan dhe gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale nga ku rezultoi se pasqyrimi i tyre në aktiv te bilancit eshte i rregullt, dhe i kuadruar me inventarin e AAM-ve. Gjendja e aktive afategjata materiale 31.12.2018 është:

Aktive afategjata materiale,me koston e blerjes dhe te krijimit.........................2.500.000 lekë

Amortizimi i akumuluar.................................................................(1.284.000) lekë
Aktive afategjata materiale neto.................................................................1.216.000 lekë

Vlerësimi fillestar në momentin e hyrjes është bërë me koston e blerjes dhe në datën e mbylljes së PF-ve paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar.
Gjatë ushtrimit aktivet afatgjata materiale nuk kanë ndryshuar , jane pakësuar me vleren e amortizimit per shumen 304.000 lekë, llogaritur sipas metodës dhe normave të përcaktuara në politikave kontabël, të cilat përputhen me politikat fiskale 20 % e vleres neto te periudhës paraardhese.

**Të pagueshmet**

Edhe nga verifikimet e gjendjeve dhe lëvizjeve te llogarive të pagueshme nuk u evidentuan mospërputhje dhe parregullsi, krahasuar me kontabilitetin dhe gjendjet e deklaruara dhe jane si vijon:

Furnitore për mallra e shërbime
I.C.E shpk (detyrim blerje makine).................................................2.500.000 lekë
Vodafon.................................................................................13.774 lekë
Shuma furnitore per aktive,sherbime..........................................2.513.774 lekë
Paga punonjesish ....................................................................1.985.272 lekë
Kontribute shoqërore shëndetsore................................................6.696 lekë
Totali detyrime..........................................................................4.505.742 lekë

Të pagueshme ndaj furnitoreve pasqyrojnë detyrimet nga blerja e aseteve dhe sherbimeve të mbetura pa u likujduar në fund të ushtrimit.
Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore dhe shendetesore jane paraqitur detyrimet e mbetura pa u paguar ne fund te vitit 2018.
Nga procedurat e kryera verifikuese për aktivet dhe detyrimet, për ekzistenca, plotësinë, të drejtat dhe detyrimet dhe vlerësimin e tyre nuk rezultuan anomali materiale dhe parregullsi në raportim.Theksoj se moslikuidimi i detyrimeve për blerje aqt më shumë se dy vite dhe pagave ve ne diskutim vijimësinë e aktivitetit të organizatës.

## III. TË ARDHURAT

### A. PËRMBLEDHJE

| | Sipas raportit vjetor | Sipas auditimit të kryer |
|---|---|---|
| **1. Financimi publik** | | |
| Shuma e granteve publike te marra | 0 lekë | 0 lekë |

| | | |
|---|---|---|
| Data e tranferites( llogaria bankare ne BKT) | - | - |
| **2.Donacionet private (individ)** | | |
| Shuma e përgjithshme e raportuar | 326.700 | 326.700 |
| Shuma e donacioneve në para nga individ me vlere individuale më të < se 100 mijë | 326.700 | 326.700 |
| Shuma e donacioneve ne natyrë | - | - |
| Paraqitja e nje liste te donatoreve | | |
| Paraqitja e të gjitha deklarimeve bankare | | - |
| Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (shuma) | | - |
| Përputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (data) | | - |
| Perputhshmëria mes çdo donacioni të raportuar dhe deklarimit bankar (donatori) | | - |
| Perputhshmëria mes çdo donacioni në natyre të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data) | | - |
| A perputhen shumat e përgjithshme? | | - |
| Respektimi i kufirit të donacionit | | - |
| **3. Financimi nga burimet e vetë partisë** | | |
| Shuma e përgjithshme e raportuar | 0 lekë | 0 lekë |
| **Shuma e përgjithshme e raportuar (Zyra Qendrore)** | | |
| Kuotat e anëtarësisë | 0 lekë | 0 lekë |
| Botimet | | - |
| Shtypshkronja | - | - |
| Marrje me qera | - | - |
| **Shuma e përgjithshme e raportuar (degët lokale)** | | |
| Kuotat e anëtarësise (jane arketuar me arke nga degët) | 0 lekë | 0 lekë |
| Botimet | | - |
| Shtypshkronja | - | - |
| Marrje me qera | - | - |
| Perputhshmëria mes çdo te ardhure te raportuar dhe deklarimit bankar (shuma) | Nuk ka diferenca ne vlere midis deklarimeve bankare dhe pasqyrimit i tyre ne raportet financiare. Te ardhura nga dhurimet jane ne bank 38 mije dhe ne ark 288 700 leke, shuma totale 326.700 leke | |

| | | | |
|---|---|---|---|
| Perputhshmëria mes çdo të ardhure te raportuar dhe deklarimit bankar (data)<br>Perputhshmëria mes çdo të ardhure te raportuar dhe deklarimit ne arken e OJF (data) | Të ardhura nga dhurimet ne banke jane arketuar ne 31/08/2018 ndersa te tjerat ne arke jane arketuar ne gjashtemujorin e pare te vitit, duke prere mandat arketim per çdo individ kontribues. Vlera e çdo transaksioni eshte me e vogel se 100 mije .Po keshtu vlera totale e çdo dhuruesi eshte me e vogel se 100 mije leke. | | |
| **4. Huatë/Kreditë** | | | |
| Shuma e pergjithsime e raportuar | | | |
| Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua) | | | |
| Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua) | | | |
| Paraqitja e dokumenteve mbeshtetese (kontratat për secilen kredi / hua) | | | |
| **5. Marrja e të ardhurave** | | | |
| Te gjithë të ardhurat në para te marra / te mbledhura permes llogarisë përkatëse | Po | | Nuk u kostatuan parregullsi |

**Kontributet e Specifikuara**

Përveç të ardhurave nga dhurimet me vlere me te vogel se 100 mije nuk janë evidentuar dhe deklaruar të ardhura të tjera qe kanë kërkesa të veçanta trasparence dhe raportimi.

## B. ANALIZA E BURIMEVE

### a.Financimi nga burimet jo publike

**Donatorët e lejuar**

Në raportin vjetor të part së janë evidentuar të ardhura nga donacionet dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit

**Burimet e palejuara**

Ne raportin vjetor të partisë nuk jane evidentuar të ardhura nga burime të palejuara dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

**Kontributet në natyrë**

Në raportin vjetor të partisë nuk jane evidentuar të ardhura nga kontribute në natyrë dhe po ashtu dhe nga procesi i auditimit.

### b.Financimi nga burimet e vetë partisë politike

**Klasifikimi me zëra i të ardhurave nga burimet e vetë partisë**

Nga burimet e partise jane ralizuar të ardhura vetem nga antaresia ne shumën 326,700 lekë, nga e cila arkëtuar drejperdrejt nga antarët në llogaritë bankare 38,000 lekë dhe te arkëtuara me lekë në dorë 288.700 lekë, si ç tregohet në tabelën vijuese.

| | Te ardhurat nga dhurimet e antarësise te partisë | Totali | Zyra Qendrore | Degët lokale |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Të ardhura nga dhurimet-Banka** | | | |
| | Banka Kombetare Tregtare | 38 000 | 38 000 | - |
| 2 | **Të ardhura nga dhurimet-Arka** | | | |
| | Tirana | 288 700 | 288.700 | |
| | **Shuma** | **326.700** | **326.700** | - |

## c.Huatë/Kreditë

Në raportin vjetor te partisë per vitin 2018 nuk jane evidentuar te ardhura nga huatë dhe kreditë dhe po ashtu ohe nga procesi i auditimit.

## IV. SHPENZIMET

### A. PËRMBLEDHJE SHPENZIMESH SIPAS NATYRES

| | Shpenzimet e deklaruara në raportin vjeter | Faturat e paraqitura | Dokumentet mbeshtetese qe mungojne | Shpenzime te papaguara | Mosperputhje ne lidhje me dokumentat e paraqitura nga furnitoret | Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shpenzimet e qerasë(Ambiente,salla etj)** | - | - | - | - | - | - |
| **Shërbimet komunale** | | | | | | |
| Energjia Elektrike | - | - | - | - | - | - |
| Uji | | - | - | - | | - |
| Shpenzime telefonike | 202 248 | Të gjitha faturat e regjistruara | - | 13774 muaji dhjetor paguar ne janar 2019 | - | 202 248 |
| **Stafi/ rrogat** | | | | | - | |

| | Shpenzimet e deklaruara në raportin vjetor | Faturat e paraqitura | Dokumentet mbeshtetese qe mungojne | Shpenzime te papaguara | Mospërputhje ne lidhje me dokumentat e paraqitura nga furnitoret | **Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit** |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Pagat | 288,000 | Listëpagesa | - | 255,744 lekë vetëm 2018 nga 1 935 272 leke pa paguar deri në dorëzimin e raportit duke përfshirë edhe vitet paraardhese | - | 288,000 |
| Sigurime shoqerore dhe shendetesore | 48 096 | Listepagesa | | 6695 muaj dhjetor paguar ne janar 2019 | - | 48 096 |
| **Media** | - | - | - | - | | - |
| **Komunikimet** | - | - | - | | - | - |
| Botimet | - | - | - | - | - | - |
| Materialet promovuese | - | - | - | - | - | |
| Sondazhet e opinionit publik/konsulenca | - | - | - | - | - | - |
| **Shpenzime udhetimi,dieta, transporti** | | | | | | - |
| Automjetet me qera dhe karburanti | - | - | | | - | - |
| Akomodimi | - | | - | - | - | - |
| Vaktet dhe shpenzime te tjera(katering) | | - | - | - | - | - |
| **Shpenzimet bankare** | 8,106 | Nxjerrje bankare bankare dhe mandat pagesa arke per taksat dhe kontributet | - | - | - | 8,106 |

| | Shpenzimet e deklaruara në raportin vjetor | Faturat e paraqitura | Dokumentet mbështetëse që mungojnë | Shpenzime të papaguara | Mospërputhje në lidhje me dokumentat e paraqitura nga furnitorët | Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Administrative dhe të përgjithshme** | 15,000 | Pagese taksash dhe tatime | - | - | - | 15,000 |
| **Amortizim** | 304,000 | Vendim I drejtimit i pershtatshem edhe me legjislacionit fiskal 20 % e vleres neto | - | - | - | 304,000 |
| **Menaxhim i Pronës** | - | - | - | - | - | - |
| **Shpenzime të tjera** | 36,000 | fatura e auditimit | - | - | - | 36,000 |
| **SHUMA** | **901,450** | | | **2.005.742 lekë në total nga te cilat vetëm 2018 pa likuiduar 276.184 lekë** | - | **901,450** |

Ambientet e marra ne perdorim janë furnizuar prej subjekteve rezident të regjistruar në sistemin tatimor, për të cilat nuk është i aplikueshëm tatimi ne burim, dhe pa faturë tatimore mqs vlera është zero.Po kështu pagat janë nën minimumin e detyrushëm për tatim page.

## ANALIZA

### a.Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruara dhe klasifikuara sipas degës së partisë dhe kategorisë.

Te gjitha shpenzimet e kryera gjate ushtrimit 2018 janë të autorizuara dhe të kontrolluara nga qendra e partisë. Autorizimi i shpenzimeve, dokumentimi, regjistrimi, klasifikimi dhe raportimi bëhen nga qendra e partisë. Kjo ndodh sepse sipas organizimit te partisë deget në qarqe nuk kanë kopetenca pavarura që të përdorin fonde dhe të administrojne pasuri, veprimet jane të perqendruara në qëndër.

### b.Verifikimi

Verifikimet e transaksioneve që lidhen me shpenzimeve për ndodhjen, plotësin, saktësine, ndarjen e periudhës dhe klasifikimin u kryen mbi bazen e vlersimit të rrisqeve, që janë karakteristike për aktivitetin e partive politike.

Bazuar në faktin se viti 2018 nuk kishte aktivitete zgjedhore por vetëm ato të funksionimit të perhershem, si rreziqe kryesore në lidhje me shpenzimet u vlerësuan: mosnjohja e një blerje për të fshehur burimin, deklarimi me shuma me të ulta se sa tregojnë dokumentat, mungesa e faturave te rregullta për shpenzimet e kryera etj.

Si pergjigje ndaj këtyre rreziqeve te vleresuara, si procedurë thelbesore u ndoq ajo e verifikimit të faturave origjinale të blerjes me pagesen e kryer dhe pasqyrimit e tyre llogaritë e blerjes (furnitorët) dhe të shpenzimeve sipas kategorive.

Nga verifikimet e kryera me përzgjedhje nuk rezultoi ndonjë parregullsi materiale.

Shpenzimet e amortizimit ishin llogaritur dhe paraqitur ne perputhje me metoden dhe normat e përcaktuara nga drejtimi, në përshtje dhe brenda kufijve fiskal.

Po ashtu u kërkua informacion për mallra dhe shërbime të marra në natyrë dhe sipas deklaratave te drejtimit nuk jane evidentuar shpenzime apo kontribute të kësaj natyrë.

## V. SINTEZA DHE OPINIONI AUDITIMIT

### A. SINTEZA

#### a. Përmbledhja e gjetjeve dhe përfundimeve.

- Ne përfunduam procesin e auditimit bazuar në vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale, morëm evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, përdorëm procedurat që gjykuam të nevojshme dhe nuk evidentuam anomali materiale si rezultat i gabimit, mashtrimit, përjashtime të qëllimshme apo informacione të deformuara në pasqyrat financiare 2018 të deklaruara nga Partia Aleanca Popullore në KQZ-ë, në të gjitha a elementët, aktivin, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.
- Po ashtu vlerësuam politikat kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi në pjësën e shenimeve të PF-ve, dhe arritëm ne konkluzionin se ato janë të drejta por duheshin shpjegime më të plota për cdo rubrikë si të bilancit edhe të pasqyrave në tërësi.
- Nga vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme dhe strukturës së pasqyrave financiare të dorëzuara nga partia per vitin 2018 në KQZ-ë, u evidentua se ato ishin përgatitur sipas SKK-së për OJF-të, siç e kërkon standardi.
- Sikurse theksuam edhe në analizën e detyrimeve, gjëndja financiare e Ojf (rezulton me detyrime dhe vështirësi financiare pra me kapitale neto negative si rezultat i të cilave vihet në dyshim vijimësia e organizatës dhe për këtë opinioni ynë do të paraqitet me rëzervë.
- Lidhur me kërkesat specifike të ligjit nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për Partitë Politike" dhe udhëzimet e KQZ-së si, burimet e financimit, procedurat e marrjes së donacioneve jopublike,burimet e lejuara, kufizimet, dokumentimit dhe të regjistrimit të tyre, identifikimin e dhuruesve, zbatimin e rregulave të publikimit të tyre, etj., nuk u gjetën parregullsi dhe shkelje ligjore.

#### b. Lista e parregullsive të gjetura gjatë proçesit të auditimit

- Ne vazhdim të çështjeve të shpjeguara më sipër gjatë procesit të auditimit nuk janë konstatuar gabime materiale, në të gjithë elementet e aktivit, detyrimeve, të ardhurave

dhe shpenzimeve, si dhe përjashtime të qëllimshme apo informacione të deformuara në pasqyrat financiare.

## B. OPINIONI

### I. Opinioni mbi Auditimin e Pasqyrave Financiare 2018

**Opinion**

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Partisë Aleanca Popullore (si pala përgjegjëse e raportimit financiar), të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2018, pasqyrën e aktiviteteve , pasqyrën e flukseve të parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare.

*Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Partisë Aleanca Popullore më datën 31 Dhjetor 2018, performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, hartuar në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK-të) dhe SKK-të për OJF-të.*

***Theksim çështje***

*Pasqyrat financiare 2018 të dorëzuara në KQZ-ë , të publikuara prej saj, dhe të paraqitura për auditim, paraqiten me aktive neto negative në shumën 3.288.962 lekë , aktiv negativ i krijuar prej më shumë se tre periudha radhazi. Në vitin 2018 shuma 574.750 lekë aktiv neto negativ, viti 2017 aktivi neto negativ 593 635 lekë dhe periudhat para vitit 2017 në shumën 2.120.577 lekë. Ky aktiv neto negativ rrezikon vijimësinë e OJF -së Partia Aleanca Popullore nëse nuk mundëson në vazhdimësi burime të ardhurash, sepse aktiviteti i organizatës është i mbuluar pjesërisht nga borxhet ndaj të tretëve.*

### II. Opinioni mbi kërkesat të tjera ligjore dhe rregullatore

Në pëfundim të verifikimeve dhe informacioneve të marra, në referencë me kërkesat, kufizimet dhe detyrimet specifike të kërkuara prej ligjit "Për Partitë Politike", i ndryshuar dhe udhëzimevë të KQZ-së, për çështjet që gjejnë zbatim në aktivitetin e kryer per ushtimin 2018, opinioni ynë është si vijon:

- Burimet e financimit të aktivitetit politik të Partisë Aleanca Popullore për periudhën raportuese 2018, kanë ardhur nga kontributet e antarësisë. Të ardhurat e realizuara dhe të deklaruara janë në përputhje me burimet e lejuara nga ligji "Për Partitë Politike".
- Nuk u evidentuan marrje të fondeve publike.
- Nuk u evidentuan marrje të fondeve jopublike, në para apo në natyrë, nga dhurues të identifikuar dhe të paidentifikuar, me shuma mbi 100 mijë lekë dhe të papublikuar.
- Nuk u evidentuan parregullsi dhe anomali materiale në zbatimin e kërkesave të legjislacionit kontabël dhe atij tatimor, për dokumentimin, merrjen në llogari, matjen, klasifikikimin dhe deklarimin e veprimeve dhe faktet ekonomike që i përkasin partisë, të lidhura me aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet.

*Shkodër, më datë 18/06/2019*

**Eftali Qirjaqi**
***Auditues Ligjor***